



Datë: 22.08.2025
Numër Protokoli: 6961/2025

A.nr.1203/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1203/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesja L.Q-H kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1203/2025, e datës 24.06.2025, e parashtruar nga ankuesja, L.Q-H.

A r s y e t i m

Ankuesja, L.Q-H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 24.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017455, për pozitën e punës, Zyrtar Administrativ në Divizionin për Patentë Shofer në Mitrovicë, të shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja me datë 24.06.2025, **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 25.03.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00017455, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Zyrtar Administrativ në Divizionin për Patentë Shofer në Mitrovicë, klasa e pozitës Profesional 3, dy (2) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 26.03.2025 deri më datën 24.04.2025. Rrjedhimisht, në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 131, ndërsa 54 kandidatë përfshirë edhe ankuesen e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, duke u konsideruar si kandidatë që kanë plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, sipas provave të përcjella nga organi publik vërehet se ankuesja nuk ka marrë pjesë në fazën e vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, dhe së më asnjë provë ankuesja nuk ka arsyetuar braktisjen e kësaj procedure të organi që ka zhvilluar procedurën e kontestuar.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 11.06.2025, ka publikuar Njoftimin për rezultatin përfundimtar të vlerësimit, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshëm për procedurën përkatëse është shpallur E.A me 84 pikë dhe S.H me 78.4 pikë.

Ankuesja, pas publikimit të Njoftimin për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të datës 11.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se për mbajtjen e testit me shkrim është njoftuar vetëm një ditë më përpara, gjë që sipas ankueses njoftimi për mbajtjen e testit me shkrim është dashur të bëhet 7 ditë para mbajtjes, shton se nuk ka pranuar asnjë informacion lidhur me vonesën e mbajtjes së testit me shkrim. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, të detyroj organin e punësimit që ti respektoj afatet ligjore në mënyrë që të jep mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo candidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil”,* si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me theks të veçantë nenit 14 ku përcaktohet se *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”,* nenit 103 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *“2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundojë, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”,* si dhe nenit 124 paragrafi 1, me të cilin parashihet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,”*, dhe si rrjedhojë referuar kësaj baze ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se me: \

Njoftimin e datës 11.06.2025 të Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si akt përfundimtar në këtë procedurë, ankueses nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik, për faktin se ankuesja me vet dëshirë e ka braktisur pjesëmarrjen në procedurën me numër reference RN00017455, dhe si rrjedhojë e njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës, ankesa A.nr.1203/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1203/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, L.Q-H;
- Udhëheqësit të personelit në MMPHI;
- Arkivit të KPMSHCK-së.